

Moisi Duda – Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Z. Duda ka mbaruar studimet e larta për drejtësi në **vitin 1990** ,në fakultetin e Drejtësisë në, Universitetin e Tiranës,

Karrierën profesionale e ka filluar si hetues, në vitet **1990 deri 1994**, pranë Hetuesisë së Rrethit Lushnje.

Në vitet 1994 deri 2000 ka ushtruar detyrën e Prokurorit, pranë Prokurorisë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kuçovë, Berat, Gramsh dhe Durrës.

Gusht 2000 deri në shkurt 2021, Z. Duda ka ushtruar detyrën e prokurorit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Shkurt 2021 deri në dhjetor 2021 z. Moisi Duda është zgjedhur anëtar (mandat zëvendësues) i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në vitin 2021 deri në **janar 2023**, z. Duda rikthehet për të vazhduar karrierën e tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në shkurt 2023 e deri sa u zgjodh si Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Duda ushtroi detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Gjatë karrierës së tij profesionale, Ai ka kryer kurse dhe trajnime të shumta, si:

Trajnim me temë “Lufta kundër krimit të organizuar”, zhvilluar në Siçili, Itali etj. apo edhe kurse të ndryshme të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë.

Z. Moisi Duda është njohës shumë i mire i gjuhës angleze.

Ai ka aftësi shumë të mira vendimmarrëse, drejtuese, organizuese etj.

Z. Moisi Duda është zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve, në datë 13 Tetor nga radhët e prokurorëve të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me një mandat 5 vjeçar..